



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2018:070386

Datë: 29.01.2019

Numri i dokumentit: 00214671

**P.nr.3/19**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti për Krime të Rënda, gjyqtari Xheladin Osmani, njëherit edhe si kryetar, me sekretaren juridike Teuta Spahija, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit M.K nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 nënpar.1.1. të KP-së, duke vendosur sipas aktakuzës së PSH-së në Prizren, PP./I.nr.3231-4/18-II e datës 11.01.2019 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datën 29.01.2019, në prezencën e përfaqësuesit të akuzës- prokurorit të shtetit Mehdi Sefa, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, av. Sh.B, po të njëjtën ditë muar dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**M.K** me nofkën “**D.**” nga i ati E dhe e ëma Z, me mbiemër të vajzërisë G, i lindur me datën ..., Komuna e Drenasit, tani me banim në Prizren, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së varfër ekonomike.

**ËSHTË FAJTOR**

Se me datë 14.12.2018 rreth orës 21:45 minuta në Prizren, në lagjen “Kurilla”, në lokalit “...”, pas në mosmarrëveshje paraprake rreth pagesës të një telefoni që i kishte R djali i vëllait i të dëmtuarit i shkakton lëndime të rënda trupore me mjet të rrezikshëm-brisk ashtu që përkohësisht dëmton shëndetin e të dëmtuarit L.R, në atë mënyrë që i akuzuari i drejtohet vëllait të të dëmtuarit R me fjalët: “ku e ke djalin, më ka borxh 40 euro për një telefon që i kam shitur”, R i është përgjigjur: “krejt çka ke me djalin tim unë do ti kryej-paguaj, për momentin jam pa para por do ti paguaj më vonë”, dhe në ato momente këtu i dëmtuari L është ngritur nga tavolina i është afruar M dhe pas një fjalosje të shkurtër ka filluar përleshja mes tyre me grushta, e më pas i akuzuari e nxjerr mjetin e rrezikshëm, briskun dhe e godet në anën e djathtë të qafës me ç’rast i shkakton lëndime të rënda trupore plagë shpuese në anën e djathtë të qafës me vëllim të zvogëluar të lëngjeve trupore si pasoj e traumës shkaktuar nga veprimi mekanik i

mjetit të mprehtë me majë e përshkruar si në mendimin e ekspertit mjeko ligjor dr. D.H e dt.20.12.2018.

Me këtë ka kryer veprën penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 nënpar.1.1. të KP-së.

Gjykata në kuptim të nenit 7,8,9,10,17,41,42,43,45,73,74,75 par.1 p.3,76 të KP.

## **G J Y K O N**

Me dënim me burg efektiv në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajve, ku do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 14.12.2018 gjerë më datën 29.01.2019.

Në bazë të nenit 69 par.1 KP-së dhe nenit 115 par.1.2 të KPP-së, prej të akuzuarit konfiskohet një brisk me dorezë të zezë me teh 5 cm, si objekt i kryerjes së veprës penale.

I dëmtuari L.R nga Prizreni, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Obligohet i akuzuari që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 50 euro në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në bazë të Qarkores së Gjykatës Supreme të Kosovës për zbatimin e Ligjit nr.05/L-36, për kompensimin e viktimave të krimit të dt.30.01.2018, obligohet i pandehuri M.K që konform nenit 39 të Ligjit të lartcekur të paguajnë se cili shumën me nga 50 euro në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria e Shtetit – Departamenti për krime të rënda në Prizren, ka ngritur aktakuzën PP./I.nr.3231-4/18-II e datës 11.01.2019, kundër të akuzuarit M.K nga Prizren, për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 nënpar.1.1. të KP-së, të cilën aktakuzë gjatë shqyrtimit fillestar e ka përfaqësuar prokurori e shtetit Mehdi Sefa.

Në seancën fillestare, i akuzuari u udhëzua në kuptim të nenit 246 të KPP për të drejtat e tij dhe pasi që të drejtat e tija janë respektuar, pas leximit të aktakuzës, i akuzuari ka kuptuar aktakuzën, i është ofruar mundësia e tij të pranojë fajësinë dhe i akuzuari pranoi fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës.

Kryetari i trupit gjykues vërtetoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit dhe se pranimi është bërë vullnetarisht, pastaj pranimi është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza, nga materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit dhe provat tjera dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të çart ligjore ose gabime faktike, i akuzuari e pranoi fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës dhe atë pas marrjes së mendimit të prokurorit, dhe vet të akuzuarit, dhe mbrojtësit të tij, mori vendimin mbi pranimin e fajësisë e pastaj është vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me vet pranimin nga ana e të akuzuarit dhe nga shkresat e lëndës, është vërtetuar në tërësi pretendimi i Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti për krime të rënda, se i akuzuari

M.K ka kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitivë të aktakuzës dhe të këtij aktgjykimi.

Gjykata, nga provat të bashkangjitur në shkresat e lëndës, mbi të cilat është bazuar dhe ngritur aktakuza e PTH-it në Prizren, e poashtu edhe nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale që i vihet në barrë, duke i analizuar secilën veç e veç dhe duke i ndërlidhur të gjitha së bashku më pa dyshim është ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen dhe fitohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit dhe se i akuzuari në aspektin penal- juridik është përgjegjës për çka gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, dhe ia shqiptoj dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata, gjatë shqiptimit dhe matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, e në kuptim të nenit 73, 74 dhe 75 par.1 p.1.3 të KP, pati parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në zgjedhjen e llojit të lartësisë së dënimit, duke e gjetur si rrethanë rënduese rrezikun shoqëror, shkallën e rrezikut të vlerës së mbrojtur, ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese është marrë sjellja korrekte e të akuzuarit gjatë tërë procedurës, pranimin e fajësisë, është penduar, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëritë vepër të njëjtë penale dhe gjerë më tani i padënuar, për këtë gjykata ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit e bindur se edhe me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi konfiskimin e sendit është marrë në kuptim të nenit 69 të KP-së dhe nenit 115 par.1.2 të KPP-së.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike u muar në kuptim të nenit 463 par.2 të KPP.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në dispozitat e nenit 450 par.2.6 të KPP-së.

Vendimin mbi kompensimin e viktimave të krimit u muar në bazë të Qarkores së Gjykatës Supreme të Kosovës për zbatimin e Ligjit nr.05/L-36, për kompensimin e viktimave të krimit të dt.30.01.2018.

Andaj, nga të cekurat si më lartë është vendosur si në shqiptim të aktgjykimit.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**P.nr.3/2019, me date: 29.01.2019**

**Sekretarja Juridike,**  
**Teuta Spahija**

**Kryetari i trupit gjykues,**  
**Xheladin Osmani**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit, nëpërmjet kësaj Gjykate për Gjykatën së Apelit në Prishtinë.